



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.12.2022

MBLEDHJA Nr. 57,
Datë 09.12.2022, ora 10:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e premte, datë 09.12.2022, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 57 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes.

KRYETARI
Petrit AHMETI